



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE  
OPERATORI I SHËRBIMEVE TË KUJDESIT SHËNDETËSOR  
SPITALI RAJONAL SHKODER

Nr. \_\_\_\_\_ prot.

Shkoder, me \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2024

MIRATOHET  
TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR  
SENAD HALLUNAJ

**PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Shërbime**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

Me date 15.07.2024 njesia e prokurimit e perbere nga Brixhilda Lazri,Fatjon Verri ,Aron Ara te ngritur me urdher prokurimi nr 31 date 15.07.2024 në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Spitali Rajonal Shkoder** harton proces-verbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e prokurimit ‘**Riparim e mirembajtje impiantistike**’ me kod(CPV**Shërbimet te ndryshme 98300000-6** me fond limit **7,956,694.23** (shtatemiljon e nenteqind e pesedhete e gjashte mije e gjashteqind e nentedhete e kater.23) **lekë pa TVSH.**

“Procedure e Hapur e Thjeshtuar”,pasi fondi limit eshte nën kufirin e ulët monetar per sherbime.kjo lidhur me fondin e Përllogaritur dhe specifikimet perkatese eshte bere me shkresen me nr 123/1 prot date 26.01.2024 per ‘**Riparim e mirembajtje impiantistike**’ **Marrëveshje kuader - me një operatore ekonomik,ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 12 muaj,për Spitalin Rajonal Shkoder.**

Njesia e prokurimit lidhur me proceduren ka hartuar kriteret me përmbajtje si më poshtë:

**I. KRITERET E VEÇANTA TËKUALIFIKIMIT**

## 1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

*a. Formularin Permbledhes te Vetedeklarimit, sipas shtojces 9*

**Argumentimi:** Ky kriter u vendos me mbeshtetje ne nenin 76 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik“, dhe nenin 26 te VKM nr. 285, date 19.05.2021 ”Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”, ne te cilen eshte e percaktuar se: “1. *Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetedeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.*”.

*b. Sigurimin e ofertes, sipas Shtojces 3 vlerën e kërkuar të sigurimit të ofertës, e cila duhet të jetë 2% e vlerës së përlogaritur të kontratës.*

**Argumentimi:** Ky kriter u vendos sipas nenit 83 Ligjin nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, ne te cilen eshte e parashikuar se:

Pika 1 Neni 83: Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël.

✓ Nga shoqëri sigurimi të licencuara nga autoritetet kompetente

Pika 2 Neni 83: Autoriteti ose enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit:

a) vlerën e kërkuar të sigurimit të ofertës, e cila duhet të jetë 2% e vlerës së përlogaritur të kontratës;

b) çdo kërkesë për natyrën dhe formën e sigurimit të ofertës, si dhe ne nenin 30 te VKM nr 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”.

Operatori ekonomik duhet të paraqesë të gjitha shtojcat sipas DST-ve të tenderit që janë Shtojcë për tu paraqitur nga operatori ekonomik (Formularin e Ofertës sipas Shtojcës 1, Lista e cmimeve te artikujve sipas shtojces 2).

*Kjo shtojce eshte pjese e setit te dokumenteve standarte te tenderit per proceduren e prokurimit te sipercituara.*

Ky kriter u vendos sipas nenit 29 te VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik“, ne te cilen eshte e parashikuar se:

1. *Oferta ekonomike përmban vlerën ekonomike pa TVSH.*

2. *Operatori ekonomik duhet të hartojë në mënyrë të pavarur, ofertën ekonomike.*

## 2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

### 2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

2.1.1 Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur me liçensë profesionale sipas modelit të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë e cila të përmbajë kategoritë e mëposhtme:

NS 2 A Impiante hidro-sanitare, kuzhina, lavanteri, mirëmbajtja e tyre.

NS 14 A Impiante të brendëshme, elektrike, telefoni, radiotelefoni TV etj.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 4, gërma a,) të VKMnr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 42, datë 16.01.2008, "Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi", i ndryshuar.

Përcaktimi i kategorisë së licencave bazohet në kriteret të përcaktuara ligjore e teknike. Te dhënat për licencat e mësipërme janë vendosur referuar bazës ligjore për ndërtimet, ligjit nr. 8402 datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” të ndryshuar, neni 8 përcakton "Zbatimi i punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga persona juridikë, privatë ose publikë, vendas ose të huaj, të pajisur me licencën përkatëse, për zbatim punimesh ndërtimore. Zbatuesi i punimeve mban përgjegjësi dhe është i detyruar të realizojë punimet e ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të zbatimit dhe rregullat e sigurimit teknik. Ai duhet të sigurojë cilësinë e materialeve të ndërtimit dhe produkteve të ndërtimit, të cilat duhet të plotësojnë kërkesat e projektit në përputhje me standartet kombëtare ose europiane.." Lidhur me nivelin e kategorive në licencë janë në përputhje me natyrën dhe fondin limit që prokurohet, si dhe kërkohet që operatorët ekonomik të japin garanci që i kanë aftësitë tekniko profesionale ne nivele të kategorive për realizimin e objektit që prokurohet.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente kompetente.

## **2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

2.2.1 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2021, 2022, 2023, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e fondit limit të kontratës.

(Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse Operatori ekonomik arrin vlerën xhiros minimale në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga Autoriteti Kontraktor).

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43 pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”i ndryshuar.

*Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.*

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore bazohet sipas ligjit nr.8438 date 28.12.1998 i ndryshuar

## **2.3 Kapaciteti teknik:**

**2.3.1.** Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20% të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” *nenin 55 pika 4/b*), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20% të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Neni 55, pika 4 germa b të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”

---

**2.3.2** Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë numrin e nevojshëm të punonjësve për realizimin dhe zbatimin e kontratës. Numri mesatar i punonjësve të siguruar për muajin e fundit nga data e zhvillimit të tenderit jo më pak se 6 (gjashtë) punonjës.

Per kete duhet te paraqese:

- a. Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për muajin e fundit nga data e zhvillimit të tenderit.
- b. List- pagesat e punonjesve sipas formatit qe kerkohet nga legjislacioni ne fuqi për muajin e fundit nga date e zhvillimit të tenderit.

*Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 9 të DST ku të specifikohen pikat e mësipërme., ndërsa dokumentacioni provues, do të dorëzohet vetëm nga Operatori Ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.*

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Autoriteti kontraktor në vendosjen e këtij kriteri kërkon garanci në lidhje me përmbushjen me sukses dhe në afat të kontratës nga ana e operatorëve ekonomikë, të cilët duhet të dëshmojnë seriozitet dhe besueshmëri gjatë kryerjes së veprimtarisë së tyre.

2.3.3 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar inxhinier per realizimin e kontrates të paktën:

-1 (nje) inxhinier elektrik

-1 (nje) inxhinier ndertimi /hidroteknik

Per kete pike duhet te paraqese:

- Listepagesat e deklaruar ne organet tatimore(formularet E-sig 025 ) muajin e fundit nga data e zhvillimit te tenderit.Punonjesit te jene te deklaruar bazuar në vkm nr 514 datë 20.09.2017 “Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve (LKP), të rishikuar”.

-Kontrate pune te vlefshme gjate periudhes se ekzekutimit te kontrates.

- Diplomat përkatëse

*Kriteri konsiderohet i permbushur me plotesimin e formularit sipas shtojcës 9 të DST **ku te specifikohen pikat e mësipërme.**, ndërsa dokumentacioni provues, do të dorëzohët vetëm nga Operatori Ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 4, gërma b) të VKMnr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.ligjin 8402 “Per kontrollin dhe disiplinimin e punimeve te ndertimit” date 10.09.1998 i ndryshuar si dhe operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

2.3.4 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar

1(nje) elektreçist

1(nje) hidrualik

1(nje) teknik ndertimi

1(nje) murator

Per kete pike duhet te paraqese:

- Listepagesat e deklaruar ne organet tatimore(formularet E-sig 025 ) ne muajin e fundit nga data e zhvillimit te tenderit.Punonjesit te jene te deklaruar bazuar në vkm nr 514 date 20.09.2017 “Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve (LKP), të rishikuar”.”.

-Kontrate pune te vlefshme gjate periudhes se ekzekutimit te kontrates.

-Dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik (të vlefshme) të lëshuara nga organizma të akredituar për këtë qëllim në Republikën e Shqipërisë.

*Kriteri konsiderohet i permbushur me plotesimin e formularit sipas shtojcës 9 të DST **ku te specifikohen pikat e mësipërme.**, ndërsa dokumentacioni provues, do të dorëzohët vetëm nga Operatori Ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.*

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të

Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës duke u bazuar edhe te puna që do të kryhet.

2.3.5 Ofertuesi duhet të disponojë minimalisht mjetet dhe pajisjet e e mëposhtme për realizimin e objektit të prokurimit:

Nr	I. Emri i mjetit	Njësi	Sasi	Statusi
1.	Mjet transporti vetshkarkues	copë	1	Pronësi ose me qera
Nr	II. Emri i pajisjeve	Njësi	Sasi	Statusi
1	Gjenerator	Cope	1	Pronësi ose me qera
2	Shkalle	Cope	3	Pronësi ose me qera
3	Matrapik	Cope	1	Pronësi ose me qera
4	Prerëse pllakash	Cope	1	Pronësi ose me qera
5	Gure Fresibel	Cope	1	Pronësi ose me qera

Si dëshmi për plotësimin e kësaj pike operatori duhet të paraqesë:

a Për mjetet në pronësi që shënohen në regjistra publikë, të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leja e qarkullimit), çertifikata e kontrollit teknik, siguracioni i mjetit dhe taksa.

b Për mjetet e marra me qira, që shënohen në regjistra publikë të paraqitet kontrata përkatëse noteriale e qirasë, shoqëruar me dokumentin që vërteton regjistrimin e mjetit (leja e qarkullimit), çertifikata e kontrollit teknik, siguracioni i mjetit dhe taksa.

c Për pajisjet që nuk shënohen në regjistrat publikë, duhet të paraqitet dokumenti që vërteton pronësinë e tyre (aktet e zhdoganimit në Republikën e Shqipërisë /faturat tatimore të blerjes/ ose cdo dokument sipas legjislacionit në fuqi).

*Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 9 të DST ku të specifikohen pikat e mësipërme., ndërsa dokumentacioni provues, do të dorëzohet vetëm nga Operatori Ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatëve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.*

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4 të nenit të 77, të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

Mbështetur në volumin e punimeve sipas preventivit për objektin “Riparim dhe mirembajtje e objekteve ndertimore ” për realizimin e punimeve për objektit e prokurimit janë të domosdoshme këto makineri:

Zotërimi i mjeteve dhe pajisjeve të mësipërme nga operatori ekonomik ofertues ka si qëllim të sigurojë autoritetin kontraktor mbi aftësitë teknike të operatorëve ekonomikë fitues potencialë, në drejtim të përmbushjes me sukses të kontratës dhe detyrimeve në zbatim të saj, konform standardeve të mirëpërcaktuara në dokumentat e tenderit.

2.3.6 Operatori ekonomik ofertues që do të realizojë këtë kontratë, duhet të jetë i pajisur dhe të paraqese çertifikatat përkatëse të vlefshme, si më poshtë:

- ISO 9001:2015 mbi “Sistemet e menaxhimit cilësisë”,
- BS OHSAS 18001:2007 mbi “Sistemet e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë” ose ISO 45001-2018 (Sistemi i Menaxhimit dhe Sigurisë në Punë)

*Certifikata te jetë leshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë*

*Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë certifikatat e kërkuara të cilësisë sipas zërave të që merr përsipër të realizojë në akt marrëveshje*

**Argumentimi:** Ky kriter i percaktuar eshte vendosur ne perputhje me piken 1 te nenit 79 te Ligjit nr.162/2020”Per Prokurimin Publik”, ne te cilen gjejme te percaktuar se:

Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit.

Ky kriter gjen mbeshtetje ne piken 1 te nenit 44 te VKM nr 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik” i ndryshuarku percaktohet se: Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit.

Gjithashtu ky kriter gjen mbeshtetje dhe ne rekomandimin e APP dhe Drejtorise se pergjithshme te Akreditimit nr. 3330 prot, date 20.03.2018 dhe nr. 145 prot, date 16.03.2018 “Rekomandim mbi hartimin e kerkesave te cilesise”.

## **II. Argumentimi i specifikimeve teknike**

### **Shtojca 5**

## FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

### **SPECIFIKIMET TEKNIKE:**

#### **Mirembajtja ne aspektin teknik perfshin:**

Lidhjen e instalimeve elektrike te demtuara dhe plotesimin me kapak ose izolimin e kutive te ndryshme elektrike nga kontakti fizik I mundshem, ndricuesve te jashtem e te brendshem.

Perforcimi I lidhjeve dhe shtrengimin e nyjeve ne instalimin e ngrohjes ne tere rrjetin.

Mirembajtja e kokave te kaldajave ( linja e ngrohjes).

Mirembajtja e tualeteve, sifoneve, ujembledhesve, rrjedhjeve ne pergjithesi si dhe pompave te ujit, sistemi I ujesjellsit.

Mirembajtja e dyerve, menteshave, bravave.

1. Materialet qe do te perdoren per zevendesim te jene te reja ne perputhje me standartet e komunitetit europian (CE) dhe te kene nje garanci kohore jo me pak se 6(gjashte)muaj.

2. Impianistika perfshin mirembajtje te kapitujeve te preventivit

Mirembajtja është aktivitet i vazhdueshem dhe i përditshëm në spital.

Mirembajtja ndërmerret që të rivendoset (riparohet) cdo pjese në të gjitha sherbimet (elktrike, hidraulike, sistemi i ngrohjes, kalorifert, sistemi i oksigjenit, ajri medical e linja e vakumit) deri në një standart të pranushem.

Mirembajtja duhet të kuptohet ndryshe nga rinovimet të cilat zakonisht janë në shkalle të madhe të aktivitetit, investimeve dhe kohës.

Mirëmbajtja ka për qëllim të udhezaje personat përgjegjes në institucione spitalore për krijimin e kushteve në standarte të ndërtesave spitalore për krijimin e kushteve dhe hapsirave sipas udhezusit për normat dhe standarte evropiane (ISO).

Me mirembajtjen e objekteve spitalore të mbrohen dhe kursehen investimet kapitale permes zgjatjes së jetës funksionale të objekteve.

Sherbimet qe do te kryhen sipas nevojave qe do te dalin gjate punes se perditshme. Materialet dhe pjeset qe jane percaktuar ne liste do te perdoren per difektet faktike qe do te ndodhin.

Sherbimi do te kryhet menjehere me marrjen e njoftimit brenda orarit zyrtar si dhe jashte tij kur gjykohet e nevojshme, per ato sherbime qe nuk presin, pasi krijojne crregullime ne aktivitetin e perditshem spitalor.



Kontraktuesi duhet te kryeje shërbimin ne nje kohe sa me te shkurter dhe ne prani te perfaqsesit te spitalit.

**Afati i lëvrimit të shërbimit është 1 muaj nga nënshkrimi i kontrates.**

**Shpërndarja:**

**Vendi dhe dorëzimi i shërbimeve: Spitali Rajonal Shkoder.**

**NJËSIA E PROKURIMIT:**

- **Brixhilda Lazri** - Juriste/Sektor i Planifikim Prokurimeve
- **Fatjon Verri** - Sp/Sektorii Planifikim Prokurimeve
- **Ing.Aron Ara** – Sp/Sektor i Teknik